



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CA-2022-01

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 qershor 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 46 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 172 dhe 173(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një Panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Njoftimin e Mbrojtjes së Haradinajt për Apelimin e Aktgjyimit dhe Versionin e Redaktuar Publik të Njoftimit për Apel të Gucatit në lidhje me Aktgjykimin KSC-BC-2020-07/F00611 [...]”(bashkërisht, “Njoftimet për Apel”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykues II lëshoi Aktgjykimin, ku, ndër të tjera, i shpalli z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë dhe me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, për frikësim gjatë procedurës penale dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur.² Trupi Gjykues i dënoi z. Gucati dhe z. Haradinaj me katër vjet e gjysmë burgim dhe gjobë prej 100 eurosh.³

2. Më 20 qershor 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj dorëzuan Njoftimet për Apel.

¹ F00008, Njoftim i Mbrojtjes së Haradinajt për Apelimin e Aktgjyimit, 20 qershor 2022; F00009/RED, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit për Apel të Gucatit në lidhje me Aktgjykimin KSC-BC-2020-07/F00611 (“Aktgjykimi”) sipas Nenit 46(1)(a), (b) dhe (c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe Rregullës 176(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), 20 qershor 2022.

² KSC-BC-2020-07/F00611, Aktgjykim, 18 maj 2022 (konfidencial), para. 1015. Versioni i redaktuar publik i Aktgjyimit u dorëzua po atë ditë. Shih KSC-BC-2020-07/F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjyimit, 18 maj 2022.

³ Aktgjykim, para. 1017.

III. CAKTIMI

3. Pas shqyrtimit të kritereve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërisë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM CAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Kai Ambos

Gjykatësen Nina Jorgensen

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelet kundër Aktgjykimit.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 21 qershor 2022
Në Hagë,
Holandë